



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 13134 Prot

Vlorë, më: 30. 10 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK
NJËSIA ADMINISTRATIVE SHUSHICË

Datë: 05.10.2023 Ora: 17:00

Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë

Baza Ligjore: Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Per të drejtën e informimit” , ligjit nr.146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

Marrin pjesë:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha; Kryetarja e Këshillit Bashkiak- znj.Elpinqi Mërkuri; Kryetari i Njesisë Administrative Shushicë – Birçe Aliraj; Kryetar i Këshillit të Qarkut Vlorë- Ervis Moncka; Sekretar i Këshillit Bashkiak-z.Daut Zeraj; Drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, keshilltare te drejtori i buxhetit dhe financës, sektori i tatim taksave kryetarë të fshatrave të Njesisë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF locale.

(Në takim morën pjesë më shumë se 34 pjesëmarrës, listëprezenca bashkangjitur)

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, ju falenderoj për pjesëmarrjen. Ky është takimi i parë me banorët dhe e çelëm me njësité administrative Shushicë, për të diskutuar mbi planifikimin e buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe projekt buxhetin e vitit 2024 per Bashkinë Vlorë. Ky është takimi i dytë që vijon me njësité administrative në prezencë edhe të anëtarëve të këshillit bashkiak, dhe do të vazhdojme me takimet e tjera, të jemi drejtëpërdrejt me komunitetin në kontakt që të kuptojmë çfarë janë problematikat apo çfarë mund ti shërbejmë komunitetit, për të mbledhur cdo koment, sygjerim dhe diskutim tuajin përpara se të miratojme projekt buxhetin e parashikuar



**Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026
dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit
2024 për Njësinë Administrative Shushicë**

*Konsultoni për më shumë linkun e publikuar në
media lokale*

<https://fb.watch/nBn3bdWuAZ/?mibextid=Iprqdp>

Pajtim Capi-Banor në Risili: Kemi këto probleme. Shkolla e Risilisë, rikonstruksioni I shkollës. Duam të rregullohet Rruga e Varezave dhe ndricimi. Për bujqësinë sillni Ministrin e Bujqësisë për takim me kryetarët dhe banorët e fshatit dhe të dëgjoj problematikat që ne kemi. Për pastrimin jemi të kënaqur. Shqetësim janë kthyer kamionët e rëndë të cilët ecin me shpejtësi brenda fshatit.

Mbarime Bregu: Lllakatund-Problem, uji i pijshem. Menaxhimi i fshatit, nuk bëhet dot një ndërtesë. S'kemi të drejtë? Ku ta kërkojmë? Problem tjetër janë kanalizimet.

Zija Isufi: Faleminderit për ardhjen tuaj, zoti kryetar. Është punuar, pork a akoma për të bërë. Një problem shumë i madh është Lumi Shushicë i cili është gëryer shumë. Jo përmytje por gërryen mbi 10 hektarë tokë. Këro nuk varen nga ju.. Duhet të loboni, 12 vjet pa u pastruar, si rezultat u mbyt Risilia. Sistemi vaditës është ndërprerë ka 2 muaj

Rikonstruksion i rrugës në Bunavi, 400 m. Në Garbian rruga 700-800m. Në Shushicë duam të rregullohen trotuarët. Merkat duam rrugët e brendshme dhe rrugën e Kishës.

Ermal Dredha: Do flasim me ministrinë.

Zija Isufi: problem kolektori, në rrjedhën e poshtme nuk është pastruar. Përmytjen fushat e Risilisë. Uji në fshatin Babicë, problem. Bankina e lumit është çarë.

Ermal Dredha: rruga e Bunavisë dhe Grabjanit, janë në buxhet.

Berti Lera: Keni qënë gjithmonë I interesuar për fshatin Mekat. Administrate na ëshët përgjigjur..problem rrugët e brendshme në fshat.



Tozo: Nuk bëjmë dot një ndërtim, nuk kemi të drejtë, ku do ta kërkojmë zgjidhjen e problemit, për një mur për një çati? Rrugët e brendshme kanë nevojë të rregullohen dhe asfaltohen.

Spiro Dema-Bunavi: Problem rruga, ka 30 vjet që nuk është vënë dorë. Duam rrugë dhe ndricim. Kemi bërë një rrugë varezash me lekët tona. Nga Njësia administrative jemi shumë të kënaqur, dera është gjithmonë e hapur.


Dasho Latifi: Komuniteti rom- Dua tju falenderoj se janë rregulluar 50 shtëpi. Duam ndricim, rrugën e varezave, rreth 50m për komunitetin romë është problem.

Bardhi-Grabian: Rruga, ndricimi, uji i pijshëm janë shqetësimet tona dhe janë gjëra që duhen bërë.

Kristaq Tito: Çertifikatat e pronësisë janë një problem që duhet të marr zgjidhje. Na ndihmoni me ASHK.

Ermal Dredha: Është problem i sistemi, sa të marrë pak rrugë. Për raste specifike mund të vini. Ka patur takime me Kryeministrin për këto probleme, asnjë nuk i ushtron presion Hipotekës pra që të jenë të gjithë në trajtim.

Birçe Aliraj: Administratori i njësisë: Dua të them faleminderit për punën e bërë nga administrata e bashkisë.

Konceptoi:  Albana Naçi

Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik